



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2019

V E N D I M

Nr. 20, Datë 06/02/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 166, datë 22.10.2018, e Z. R.Ll, ku pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”, “orientimit seksual”, “përkatësisë në një grup të veçantë” nga ana Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, Zyrës së Ndhmës Ekonomike, pranë Bashkisë Korçë dhe KMCAP Korçë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, Z. R.Ll banon në qytetin e Korçës dhe i përket komunitetit rom dhe komunitetit LGBT, të këtij qyteti. Ankuesi shprehet se jeton i vetëm, pasi prindërit e tij kanë ndërruar jetë², si dhe është i papunë. Për shkak të mungesës së të ardhurave, ankuesit i është ndërprerë furnizimi me ujë të pijshëm dhe me energji elektrike. Z. R.Ll shprehet se i është ndërprerë edhe Kemp-i nga KMCAP Korçë, edhe pse nga Spitali Psikiatrik në Tiranë është lëshuar rekomandim për përfitim kempit, pasi ankuesi është diagnostikuar me prapambetje mendore³. Z. R.Ll thekson faktin se është paraqitur pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit

¹Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

² Referuar certifikatës familjare të ankuesit, Nr. 014745794, datë 06.11.2018, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Korçë.

³ Referuar aktit “Fletëdrejtimi për kemp” Nr. 1456, Regj. 986, datë 20.05.2003, të Komisionit Mjekësor, Korçë dhe Vendimit nr. 31105/2016 të KMCAP Korçë.

Kombëtar të Punësimit Korçë për të siguruar punësim, ku edhe i është rekomanduar punësim në firma private, por këto të fundit kanë refuzuar ta punësojnë. Ankuesi pretendon se Zyra e Ndhmës Ekonomike nuk e lejon që ai të aplikojë për përfitim ndihmë ekonomike në mungesë të statusit si punëkërkuar i papunë. Z. R.Ll kërkon ndërhyrjen e Komisionerit për përfitim të ndihmës ekonomike dhe për t'u punësuar, si dhe për të përfituar kemp.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 166, datë 22.10.2018, së Z. R.Ll dhe plotësimit të saj me dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga KMD, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga nenin 33, pika 3, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua subjekteve kundër së cilave drejtohej ankesa, si dhe për dijeni ankuesit, me shkresën nr. 1460/1/1, datë 06.11.2018, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
- Informacion mbi arsyet e mosregjistrimit të ankuesit si punëkërkuar i papunë nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, në kushtet, kur ai ende rezultoi i papunësuar, si pasojë e refuzimit për punësim nga punëdhënësi të ndryshëm;
 - Informacion mbi punëdhënësit, tek të cilët Drejtoria Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë e ka drejtuar ankuesin për punësim;
 - Informacion nëse Z. R.Ll është paraqitur për të aplikuar për ndihmë ekonomike, pranë Zyrës së Ndhmës Ekonomike, të Bashkisë Korçë. Nëse ankuesit nuk i është mundësuar aplikimi për ndihmë ekonomike, të jepet informacion mbi mangësitë në dokumentacion që ai ka patur;

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t'u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- Informacion, nëse me Vendim të KMCAP Korçë, Z. R.Ll ka përfituar kemp, në të kaluarën. Nëse po, të përcillet pranë KMD-së, vendimi/et përkatës/e të KMCAP-së, si dhe rekomandimet e lëshuara nga Spitali nr. 5, Tiranë, në lidhje me ankuesin. Njëkohësisht, nëse ankuesi ka përfituar dikur të drejtën për të përfituar kemp, Komisioneri kërkon informacion mbi arsyet e ndërprerjes së tij.
1. Në përgjigje të shkresës nr. 1460/1/1, datë 06.11.2018, të Komisionerit, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë dërgoi shkresën nr. 1042, datë 14.11.2018, nëpërmjet së cilës informon se rasti i ankuesit R.Ll është trajtuar me përparësi nga ana e tyre. Duke qenë se ankuesi ka qenë i interesuar për punë, ky institucion i ka dhënë informacion mbi vende të lira pune. Ankuesi ka treguar gatishmëri për të punuar dhe është paraqitur pranë punëdhënësit të rekomanduar, por sipas informacionit të dhënë prej tij, rezulton se ai është refuzuar nga punëdhënësit. Në vijim, ankuesi R.Ll është kontaktuar nga struktura përgjegjëse e këtij institucioni dhe pas intervistimit është regjistruar si punëkërkues i papunë.
 2. Në përgjigje të shkresës nr. 1460/1/1, datë 06.11.2018, së Komisionerit, Bashkia Korçë dërgoi shkresën nr. 1638, datë 21.11.2018, ku sqaron se ky institucion është në dijeni të plotë të problematikës së Z. R.Ll. Ky institucion ka sqaruar se ka kontaktuar me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë dhe janë vënë në dijeni të faktit, se ankuesi është regjistruar si punëkërkues i papunë, në datën 09.11.2018 dhe në këto kushte, ai mund të paraqitet pranë Administratorëve të Ndihmës Ekonomike të Njësisë përkatëse, për të aplikuar për trajtim me ndihmë ekonomike. Për sa i përket mospranimin të aplikimit të ankuesit, deri në këtë periudhë, Bashkia Korçë sqaron se është detyrim ligjor i këtij institucioni, të kërkojë nga aplikanti paraqitjen e kartelës së papunësisë, së nënshkruar nga Zyra e Punës, për të filluar aplikimin për ndihmë ekonomike.
 3. Në vijim, Komisioneri informohet nga specialistja e Zyrës së tij Vendore Korçë, me e-mailin e datës 12.11.2018, se ankuesi i konsideron të zgjidhura çështjet, që kanë lidhje me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë dhe Bashkinë Korçë. Për këtë arsye, kërkohet që ankesa të ndiqet vetëm ndaj subjektit KMCAP Korçë.
 4. Në kushtet kur, KMCAP Korçë nuk i dërgoi përgjigje zyrtare shkresës nr. 1460/1/1, datë 06.11.2018, KMD iu drejtuar sërisht këtij Komisioni, me shkresën nr. 1720, datë

13.12.2018, ku i bëhet kujtesë për kthim përgjigje brenda datës 19.12.2018. Pavarësisht sa më sipër, KMCAP Korçë nuk dërgoi përgjigje me informacionin e kërkuar nga KMD.

- C. Në vijim të procedurave hetimore mbi ankesën nr.166, datë 22.10.2018, e Z. R.LI, si dhe në mungesë të informacionit të dërguar nga KMCAP Korçë, Komisioneri vendosi për realizimin e një seance dëgjimore, në datën 14.01.2019. Nëpërmjet shkresës nr. 28, datë 07.01.2019, KMD i njoftoi palët për ndryshim të seancës dëgjimore, për në datën 23.01.2019, ora 12:00.

Para datës së zhvillimit të seancës dëgjimore, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë dërgoi pranë KMD-së, 2 (dy) shkresat e mëposhtëme:

- Shkresën nr. 789, datë 26.12.2018, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin, se në bazë të Vendimit nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”*, (i ndryshuar), Z. R.LI është trajtuar me pagesë si person me aftësi të kufizuara nga ky institucion, që nga data 30.04.2013, deri më 31.03.2017. Trajtimi me kemp ndaj ankuesit është ndërprerë, pasi që prej kësaj periudhe, ai nuk ka paraqitur asnjë dokument për të vazhduar procedurën e trajtimit me Kemp me Vendim të KMCAP Korçë.
- Shkresën nr. 41, datë 09.01.2019, ku citohet: *“Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 1772 prot, dt. 21.12.2018, administruar pranë zyrës tonë me nr. 789 prot, dt. 24.12.2018, në lidhje me problematikën e Z. R.LI, ju bëjmë me dije se: “Nuk është në kompetencën e institucionit tonë, të japim pretendime lidhur me KMCAP Korçë, për dosjen e Z. R.LI, pasi fleta e drejtimit për në KMCAP jepet nga mjeku specialist, në bazë të diagnozës së pacientit, për t’u marrë më pas vendimi nga ky komision, nëse i sëmuri do të trajtohet me kemp apo jo. Ndaj besojmë se nuk është e arsyeshme të merret pjesë në seancën dëgjimore që do të realizohet pranë zyrës tuaj.”*

Seanca dëgjimore u zhvillua në prezencë të përfaqësuesve të Komisionerit dhe ankuesit R.LI, pasi KMCAP Korçë nuk u përfaqësua në këtë seancë. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e KMD-së e njohën ankuesin me përmbajtjen e dy shkresave të sipërpërmendura të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë. Ankuesi pohoi faktin se nuk e kishte dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për përfitim kemp, pasi personi që e kishte ndihmuar më parë për ta përgatitur këtë dokumentacion, aktualisht ishte i pamundur. Në kushtet kur, u konstatua se Z. R.LI kishte nevojë për ndihmë, përfaqësuesit e KMD-së ranë dakord me të, që specialistja e

KMD-së, pranë Zyrës Vendore Korçë ta shoqëronte ankuesin pranë institucioneve përkatëse, për të përgatitur dokumentacionin e vlefshëm për përfitim kempit dhe në vijim do ta dorëzonin së bashku pranë KMCAP Korçë.

Njëkohësisht, ankuesi R.Ll u shpreh se tërhoqte ankesën e tij ndaj Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë dhe Zyrës së Ndhmës Ekonomike, pranë Bashkisë Korçë, pasi falë ndërhyrjes së Komisionerit, ai kishte arritur të regjistrohej si punëkërkuar i papunë, si dhe kishte aplikuar dhe përfituar ndihmë ekonomike. Gjatë seancës dëgjimore, Z. R.Ll nënshkroi një kërkesë për tërhoqje të ankesës së tij ndaj 2 (dy) institucioneve të sipërpërmendura.

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Në ankesën nr. 166, datë 22.10.2018, e Z. R.Ll pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”, “orientimit seksual”, “përkatësisë në një grup të veçantë” nga ana Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, Zyrës së Ndhmës Ekonomike, pranë Bashkisë Korçë dhe KMCAP Korçë.

Në kushtet kur, ankuesi ka nënshkruar Kërkesën për tërhoqje ankese, të datës 23.01.2019, ndaj Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë dhe Zyrës së Ndhmës Ekonomike, pranë Bashkisë Korçë, pasi ai ka arritur të regjistrohej si punëkërkuar i papunë, si dhe ka aplikuar dhe përfituar ndihmë ekonomike, Komisioneri në referencë të nenit 94, pika 1, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” përfundon proçedurën e shqyrtimit administrativ për këto dy subjekte.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkaqet e mësipërme, nga ana e KMCAP Korçë, Komisioneri vlerëson se:

Në pikën I/1, të Vendimit nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të

kufizuar”, (i ndryshuar) përcaktohet se personat, të cilëve u është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, të intelektit, psikiko/mendore, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje, të përkohshme apo të përhershme, që nuk vijnë nga shkaqe, që lidhen me punësimin, e vërtetuar kjo nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar.

Referuar dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, në cilësinë e provës, Z. R.LI është diagnostikuar me prapambetje mendore të moderuar dhe referuar korrespondencës zyrtare me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, ai ka përfituar ndihmë ekonomike me Vendim të KMCAP-së, nga viti 2013, deri në vitin 2017. Nëpërmjet Vendimit nr. 31105/2016, të KMCAP Korçë, Z. R.LI ka përfituar 1 (një) vit ndihmë ekonomike. Sipas vendimit të sipërpërmendur, afati i rikomisionimit në KMCAP ka qenë muaji janar 2017.

Në pikën III/19, të Vendimit nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”*, (i ndryshuar) përcaktohet shprehimisht procedurat dhe dokumentacioni për përfitimin e pagesës për aftësi të kufizuar, si vijon:

“Personat, që kërkojnë të komisionohen për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, duhet të paraqesin në seksionet e ndihmës dhe të përkujdesjes shoqërore të bashkisë/komunës, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Certifikatën e gjendjes familjare;*
- b) Certifikatën personale me fotografi;*
- c) Vendimin e mëparshëm të KMCAP-it, i cili vërteton shkallën e aftësisë së kufizuar të personit;*
- ç) Fletëdrejtimin për në KMCAP, kur personi komisionohet për herë të parë;*
- d) Epikrizën përcjellëse, sa herë rikomisionohet.”*

Nga hetimi administrativ i ankesës së Z. R.LI, rezulton se ai nuk e ka depozituar dokumentacionin e nevojshëm për rikomisionim, pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë, në muajin janar 2017, sikurse është përcaktuar në Vendimin nr. 31105/2016, e KMCAP Korçë. Në mungesë të depozitimit të dokumentacionit përkatës të përcaktuar në VKM-në e sipërpërmendur, KMCAP Korçë nuk ka patur mundësinë e marrjes në shqyrtim të rastit të ankuesit e si rrjedhim, ai nuk ka përftuar pagesën për aftësinë e kufizuar.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se në referencë nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankuesi nuk i është ekspozuar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e KMCAP Korçë.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e KMCAP Korçë ndaj ankuesit, nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për shkaqet e pretenduara nga Z. R.LI.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 17 dhe nenin 94, pika 1, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe pikave I/1 dhe III/19, të Vendimit nr. 618, datë 07.09.2006 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, (i ndryshuar),

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 166, datë 22.10.2018, lidhur me pretendimet për diskriminim, për shkak të “racës”, “orientimit seksual”, “përkatësisë në një grup të veçantë”, të Z. R.LI kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë dhe Zyrës së Ndihmës Ekonomike, pranë Bashkisë Korçë, pasi ankuesi ka depozituar pranë KMD-së, kërkesë për tërheqje të ankesës ndaj këtyre subjekteve.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “racës”, “orientimit seksual” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”, të Z. R.LI, nga KMCAP Korçë.
3. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – të mira dhe shërbime
Shkak - “raca”, “orientimi seksual”, “përkatësia në një grup të veçantë”